



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 18.05.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 , nenit 8, 9,10 dhe 13. e të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe Përfundimit Nr. 06-31800-6/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt. 07.05.2015, më të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të promovimit të albumit “Guida me këngë” të znj. Flaka Goranci, me dt: 18.05.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport e evidentuar me nr. 10-400-33655 e dt. 15.05.2015, për ndihmë financiare për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të promovimit të albumit “Guidë me këngë” të znj. Flaka Goranci, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1.000€.
2. Autorizohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1.000€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e znj. Flaka Goranci nr.1140138703000129 në ProCredit Bank.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Znj. Flaka Goranci
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

